

VENDIM
Nr.703, datë 16.11.2005

**PËR FURNIZIMIN ME KARBURANT, PA AKCIZË, PËR MEKANIKËN BUJQËSORE, SERAT
ME NGROHJE DHE SUBJEKTET QË KANË KALDAJA NË LINJAT E PËRPUNIMIT TË
QUMËSHITIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, të ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” dhe të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fermerët, në të gjithë vendin, që kryejnë punime të mekanizuara në bujqësi, që kanë sera me ngrohje, si dhe subjektet që kanë kaldata në linjat e përpunimit të qumështit, të furnizohen me karburant, pa akcizë, me një çmim 40 lekë/litri.

2. Fermerët që nuk paguajnë taksë për tokën bujqësore, sipas ligjit nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, nuk përfitojnë nga ky vendim.

3. Karburanti pa akcizë të sigurohet nga “ARMO” sh.a. dhe furnizimi të bëhet nëpërmjet pikave të shpërndarjes, në të gjithë vendin, të miratuara nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me propozimin e organeve të pushtetit vendor.

4. Efektet financiare prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh, për 6-mujorin e parë, për diferencën ndërmjet çmimit të programuar vjetor të ARMO sh.a. e çmimit 40 lekë/litri të paguar nga përfituesi, si dhe kostoja për kryerjen e shërbimit në pikat e karburantit që nuk janë të ARMO sh.a. të parashikohen në Buxhetin e Shtetit të vitit 2006 për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

5. Normativat bazë të harxhimit të karburantit:

a) sipas kulturave bujqësore të jenë për:

- të lashtat, 70-80 litra/ha;
- foragjeret, 70-80 litra/ha;
- misrin, 90-100 litër/ha;
- pemët frutore dhe vreshtat, 85 litra/ha;
- perimet, patatet etj., 80 litra/ha.

b) për serat me ngrohje, 160 tonë solar/ha ose 155 tonë gazoil/ha.

c) për linjat e përpunimit të qumështit, 25 litra karburant për 1 ton qumësht të përpunuar.

6. Drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, të përgatisin regjistrin e fermerëve, që të shërbejë për përlogaritjet e sasisë së karburantit për çdo përfitues.

7. Procedurat dhe skemat e shpërndarjes së karburantit caktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha